- Pasaporta(t) dhe kopje të pasaportave - të rritur dhe fëmijë (Originalin/et dhe nga një fotokopje të qartë të tyre; fotokopja do të dorëzohet tek mjeku);
- Kartelën/at personale të vaksinimit dhe kopje të saj (Originalin/et dhe nga një fotokopje të qartë të tyre; fotokopja do të dorëzohet tek mjeku);



Udhëzimet e Vizitës Mjekësore

↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

- Dokumentin që ju njofton datën e intervistës për vizë (ose në mungesë të saj ju duhet të jepni PATJETËR numrin e çështjes suaj, p.sh.: TIA201856700011, ose 2018EU00012345);
- Për çdo person gjashtë (6) fotografi me përmasa 3x4 cm ballore të nxjerra 6 muajt e fundit.
- Nëse mbani syze, duhet të sillni vizitën nga okulisti që tregon diagnozën dhe vizusin me korrigjim dhe pa korrigjim.
- Tregojini mjekut të gjitha sëmundjet që keni dhe mjekimin përkatës, si dhe dokumentacion mbi diagnozën, analiza shëndetësore për sëmundje aktuale, raportet shëndetësore, epikriza nga spitali për operimet që keni kaluar, analiza, të cilat këshillohet t'i keni me vete për të evituar riparaqitjen ose ekzaminimet shtesë. Gratë shtatzana duhet të kenë me vete ekzaminimin EKO me film dhe përshkrimin nga mjeku gjinekolog të moshës së shtatzanisë.
- DS-260 faqe konfirmimi

I gjithë dokumentacioni shqip (origjinalet dhe fotokopjet) nuk ka nevojë për përkthim ose noterizim.

Tarifa e vizitës mjekësore: Pagesa e vizitës mjekësore **nuk** kthehet pavarësisht nga rezultati i aplikimit tuaj për vizë emigrimi.

Nga mosha 0 deri ne 2 vjec tarifa e pagesës eshte 105 Dollare,

Nga 2 vjec deri ne 14 vjec tarifa e pagesës eshte 230 Dollare

Nga 15 vjec deri ne 17 vjec tarifa e pagesës eshte 170 Dollare

Nga mosha 18 deri ne 24 vjec tarifa e pagesës eshte 210 Dollare,

Nga 25 vjec deri ne 44 vjec tarifa e pagesës eshte 190 Dollare

Nga 45 vjec dhe me shume tarifa e pagesës eshte 170 Dollare

Gjatë Vizitës Mjekësore

Vizita mjekësore përfshin një shqyrtim të historikut tuaj mjekësor, ekzaminim fizik, radiografi të krahavorit, testi i gonorresë, dhe testet e gjakut (për aplikantët 15 vjeç e lart). Ligji i Imigracionit i Shteteve të Bashkuara kërkon testin e tuberkulozit (TB) për të gjithë aplikantët dy vjeç e lart në rast se ka simptoma të tuberkulozit apo të HIV në familje. Përgatituni të flisni me mjekun rreth historikut tuaj mjekësor, barnat që po përdorni aktualisht, dhe trajtimet që po merrni aktualisht. Për më tepër informacion mbi kërkesat e përgjithshme mjekësore për imigrantët e Shteteve të Bashkuara, lutemi lexoni në cdc.gov.

Ju lutemi vini re se si ju ashtu dhe anëtarët e familjes suaj do të duhet të shpenzoni gjithë ditën duke iu nënshtruar ekzaminimeve të ndryshme mjekësore në zyrën e mjekut. Pasi rezultatet të jenë në dispozicion, do të duhet të nënshkruani formularët mjekësorë para mjekut .

Gjatë kontrollit mjekësor mund të lindë nevoja për ekzaminime shtesë për të përcaktuar gjendjen shëndetësore. Nëse mjeku do t'ju kërkojë analiza shtesë për ju, ju duhet të ndiqni udhëzimet e stafit mjekësor. Tarifat për ekzaminimet shtesë janë në ngarkim të aplikantit, përveç trajtimit të Tuberkulozit. Nëse sëmundja ose problemi shëndetësor njihet



Udhëzimet e Vizitës Mjekësore

paraprakisht, për sqarim nevojiten raportet shëndetësore, epikriza nga kartoteka e spitalit, librezat shëndetësore, dhe të cilat këshillohet t'i kenë me vete për të evituar riparaqitjen ose ekzaminimet shtesë. Gratë shtatzana duhet të kenë me vete ekzaminimin EKO me film dhe përshkrimin nga mjeku gjinekolog të moshës së shtatzanisë.

↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

E rëndësishme: Sipas Udhëzimeve të Qendrës për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (CDC), juve mund t'ju kërkohet t'i nënshtroheni analizave të mëtejshme për Tuberkuloz (TB) ose për gonorreë. Përgjigja e analizave të TB-së mund të marrë 8-10 javë. Seksioni Konsullor do të njoftohet me listën e aplikantëve të referuar për analizat e TB-së dhe të gonorreës, ndaj ju nuk do të hasni vonesa në ditën tuaj të intervistës për vizë.

Nëse aplikanti rezulton pozitiv, ai ose ajo do t'i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm të TB-së ose gonorresë nga stafi mjekësor. Ju nuk do të paguani tarifë tjetër për trajtimin e TB-së.

Njoftim: Data e skadimit të vizës suaj do të kushtëzohet nga data e skadimit të raportit mjekësor. Formularët mjekësorë të klasifikuar si Class B (TB) janë të vlefshme për 3 muaj nga data që e firmos mjeku. Të gjithë formularët e tjerë të klasifikuar si "Nuk ka sëmundje të dukshme" janë të vlefshëm për 6 muaj nga data që e firmos mjeku. Nëse rasti juaj kalon për proces administrativ të mëtejshëm, apo shqyrtimi i rastit tuaj vonohet për shkak të dokumenteve që

mungojnë, raporti mjekësor mund të skadojë përpara se viza të lëshohet. Në këtë rast, juve do ju kërkohet të kryeni edhe njëherë vizitën mjekësore dhe ta dërgoni zarfin mjekësor në Seksionin Konsullor përpara se ju të merrni vizën tuaj.

Udhëzime për Vaksinimin

Ligji i imigracionit i Shteteve të Bashkuara kërkon që aplikantët e vizës imigruese të kenë bërë disa vaksina përpara se t'ju lëshohet viza. Kërkesat aktuale mbi vaksinat për imigrantët gjenden në [cdc.gov](https://www.cdc.gov). Gjithashtu, ju mund të lexoni edhe [Pyetje të Shtruara Shpesh](#) mbi kërkesat e vizitës mjekësore.

Në ditën e vizitës mjekësore, aplikanti kryesor dhe pjesëtarët e familjes për vizë duhet të dorëzojnë kartelat personale të vaksinimit (TË RRITUR DHE FËMIJË), ku do të pasqyrohen imtësisht të gjitha vaksinat që ata kanë bërë që nga fëmijëria dhe deri në ditën e vizitës mjekësore. Kartelat e vaksinimit që pranohen të vlefshme janë vetëm ato që lëshohen nga konsultorët, qendrat shëndetësore dhe drejtoritë rajonale të shëndetit publik. Aty duhet të jenë të dokumentuara emri, atësia, mbiemri i personit, datëlindja e saktë, datat e sakta të vaksinimeve dhe të rivaksinimeve (dita/muaji/viti). Kartelat personale të vaksinimit do të jenë të vullosura me vulën e konsultorit/qendrës shëndetësore/drejtorisë rajonale të shëndetit publik dhe të kenë vulën e mjekut që e lëshon këtë dokument. Vulat dhe emri i mjekut duhet të jenë të lexueshme.

Dokumenti i vetëm që vërteton vaksinimin tuaj është kartela personale tip e vaksinimit. Përveç këtij dokumenti vaksinimi, nuk do të njihet si i vlefshëm asnjë dokument tjetër. PËR ÇFARËDO LLOJ ARSYEJE në qoftë se në vizitën mjekësore nuk do të paraqisni kartelën personale të vaksinimit ju do të konsideroheni të pavaksinuar. Në rast se në kartelën personale të vaksinimit janë regjistruar datat e vaksinimit vetëm për disa vaksina dhe vaksinat e tjera janë pa data (ju mund të pretendoni se janë kryer por nuk janë të dokumentuara) këto të fundit do të konsiderohen të pakryera, pra ju do të konsideroheni të pavaksinuar me to.



Udhëzimet e Vizitës Mjekësore

Kini parasysh: Stafit mjekësor do t'ju udhëzojë për çdo vaksinë që duhet bërë. Gjatë sezonit të gripit, stafit mjekësor udhëzojë të kryeni vaksinën e gripit (e detyrueshme), e cila ka një kosto shtesë.

↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

Përveç vaksinave të lartpërmendura ju mund të keni kryer edhe vaksina të tjera jashtë shtetit, të cilat mund të mos kenë hyrë në Shqipëri dhe ju mund t'i keni kryer. Nëse keni dokumentacion zyrtar për to, duhet ta paraqisni gjatë vizitës mjekësore. Aplikantët që kanë qenë gjatë 12 muajve të fundit në këto shtete: Pakistan, Siri, Guinea Ekuadoriale, Afganistan, Etiopi, Irak, Izrael, Somali, apo Nigeri, duhet të sjellin prova të vaksinimit për Poliometit dhe të deklarojnë që kanë qenë në një nga këto shtete pranë stafit mjekësor.

Pas Vizitës Mjekësore

Pasi të keni përfunduar vizitën mjekësore, mjeku **do ti dërgojë ato drejtpërdrejt në Konsullatën e Sh.B.A. përreth dy ditë mbas datës së kryerjes së vizitës mjekësore.**

Mjeku nuk do t'ju dorëzojë CD-në e radiografisë së kraharorit, përveç rasteve me azil, aplikanteve të DV, aplikanteve të vizës per feje (K1), të cilët duhet të mbajnë CD-në e rrezeve X në një çantë dore së bashku me paketën e vizës kur të udhëtoni për në Shtetet e Bashkuara për herë të parë (me vizën tuaj imigruese) dhe do ia dorëzoni oficerit të imigracionit në pikën e hyrjes në Shtetet e Bashkuara. Viza juaj do të limitohet sipas datës së skadimit të vizitës mjekësore. Juve do t'ju jepet një kopje e formularit të vaksinave, i cili mund t'ju kërkohet për të regjistruar fëmijën në shkollë, etj.

Lista e Dokumentacionit Para Intervistës



Përdorni listën e mëposhtme për të përcaktuar dokumentet që SECILI aplikant, pavarësisht moshës duhet të dorëzojë (jo me DHL) në Seksionin Konsullor dy (2) javë përpara datës së intervistës, përveç rasteve kur janë udhëzuar ndryshe nga Seksioni Konsullor. Dërgojini dokumentet me postë të shpejtë në Seksionin Konsullor të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, përveç rastit kur ka mbetur më pak se 10 ditë nga data e intervistës tuaj. Në këtë rast, sillini të gjitha dokumentet në ditën tuaj të intervistës. Dokumentet që nuk janë në Shqip apo në Anglisht duhet të jenë të përkthyer në Anglisht dhe të noterizuara. Gjithashtu, vendimet e gjykatave mbi divorcin, apo mbi një krim duhet të jenë të përkthyer nga një përkthyes kompetent dhe të noterizuara:

- Një fotokopje e faqes biometrike të pasaportës (ku ndodhet emri juaj dhe fotografia) të vlefshme mbi gjashtë (6) muaj nga data juaj e hyrjes në Shtetet e Bashkuara. Mos e dërgoni pasaportën tuaj me postë, pasi do t'ju duhet gjatë vizitës mjekësore. Ju .
- Dy (2) fotografi me ngjyra me sfond të bardhë për çdo person që aplikon për vizë (5 cm x 5 cm, ose 2 inch x 2 inch). Lutemi shikoni [kërkesat e fotografisë](#) këtu.
- Fletën e konfirmimit të formularit DS-260, Aplikimi për Vizë Imigruese që ju keni plotësuar online tek ceac.state.gov/iv.
- Fletën e rregjistrimit të shërbimit postar DHL. Secili aplikant duhet të regjistrojë ditën e intervistës sipas udhëzimeve :** <https://ais.usvisa-info.com/en-al/iv> .
- Një (1) certifikatë lindjeje sipas formatit në 6 gjuhë për secilin aplikant që ka lindur në Shqipëri lëshuar nga Portali e-Albania. Certifikata **nuk** duhet të lexojë Certifikatë Personale. Nëse keni lindur jashtë Shqipërisë dhe keni shtetësi shqiptare, përveç certifikatës tuaj shqiptare të lindjes, ju duhet të sillni certifikatë lindjeje nga shteti ku ka lindur aplikanti, e përkthyer në Anglisht dhe e noterizuar.
- Vizita Mjekësore . Në rast ripërsëritje të intervistës, apo për shkak mosparaqitje, Seksioni Konsullor mund t'ju kërkojë ta kryeni vizitën mjekësore .
- Vërtetime të emrit/ të mbiemrit të ndryshuar: Në rast se keni ndryshuar emrin/mbiemrin, sillni Vërtetim/Dëshmi ose Certifikatë që e vërteton një gjë të tillë, të lëshuar nga autoriteti shtetëror përkatës.
- Kopje origjinale ose të certifikuara të certifikatave të lindjes për të gjithë fëmijët e kërkuesit kryesor (*edhe nëse nuk shoqërohet*).

Aplikantët e kategorive të mëposhtme me shkronja të pjerrëta duhet të sjellin këto dokumente shtesë:

Për aplikantët me bazë familjare:

- Formularin [I-864 Garancia e Mbështetjes](#) nga sponsori për **secilin** peticion, së bashku me kopje të [transkriptit të IRS](#)-së të sponsorit, ose taksat federale të vitit më të fundit, formulari 1040, dhe formularin W-2 (nëse aplikohet).
- Nëse sponsori është i/e martuar, bashkëshorti ose bashkëshortja e tij/saj duhet gjithashtu të plotësojë dhe dorëzojë formularin I-864A (vini re: formulari I-864A është i ndryshëm nga I-864). Shiko ketu: <https://www.uscis.gov/forms/all-forms/tips-for-filing-form-i-864a-contract-between-sponsor-and-household-member>, e shoqëruar nga dëshmi e statusit dhe të rezidencës në Shtetet e Bashkuara (fotokopje e pasaportës amerikane, e certifikatës së naturalizimit, ose e kartës së banorit të përhershëm të ligjshëm) e tij /e saj.
- Dëshmi të lidhjes ndërmjet petitionerit dhe aplikantit të vizës (si p.sh.: fotografi, letra, apo emaille).

Lista e Dokumentacionit Para Intervistës



↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

- Dëshmi e statusit të peticionerit dhe [të rezidencës \(domicile\)](#) në Shtetet e Bashkuara (fotokopje e pasaportës amerikane, e certifikatës së naturalizimit, ose e kartës së banorit të përhershëm të ligjshëm).
- Certifikatë lindjeje e peticionerit (e qytetarit amerikan, apo me green card) dhe certifikatë martese (nëse aplikohet), e cila të jetë lëshuar më pak se një vit nga data e intervistës. Nëse vendlindja, apo martesë është në Shqipëri lëshohen nga Zyrat Shqiptare (ne formatin 6 gjuhë) ose nga Portali i “ e-Albania”
- Sponsori Shtesë: Nëse të ardhurat e peticionerit janë [nën 125 përqind të nivelit të varfërisë \(U.S. poverty guideline\)](#), peticioneri juaj përveç garancisë së tij të mbështetjes, Formulari I-864, duhet të sigurojë edhe një sponsor tjetër, ose të përdorë të ardhurat e një pjesëtari të familjes në mënyrë që të përmbushë kërkesën e të ardhurave. Secili sponsor shtesë dhe/ose pjesëtar i familjes duhet të plotësojë **formularin e saktë I-864, Garancia e Mbështetjes** së bashku me një fotokopje të transkriptit të IRS-së të sponsorit, ose taksat federale të vitit më të fundit, dhe formularin W-2 (nëse aplikohet). *Peticioneri juaj duhet patjetër të dorëzojë formularin e tij I-864, pavarësisht faktit që ka ose jo një sponsor shtesë për çështjen tuaj.*
- Nëse jeni i/e martuar:* certifikatë origjinale martese. Pranohen si certifikatat e martesës që janë në formatin 6 gjuhë lëshuar nga Zyrat Shqiptare ose nga Portali i “ e-Albania”
- Nëse keni qenë i/e martuar më parë:* Vendimin e gjyqit mbi divorcin të përkthyer në Anglisht dhe të noterizuar, ose certifikatë vdekjeje të bashkëshortit/es tuaj.
- Nëse jeni i/e birësuar:* Vendimin e gjykatës mbi birësimin të përkthyer në Anglisht dhe të noterizuar.
- Nëse jeni thjeshtri i peticionerit:* Certifikatë martese të peticionerit dhe të prindit tuaj biologjik dhe vendimin/et e gjyqit/eve të prindërve mbi divorcin të përkthyer në Anglisht e të noterizuar.
- Për vizat me bazë punësimin:* Letër nga punëdhënësi juaj të lëshuar jo më parë se një muaj nga data e intervistës.
- Nëse jeni mbi 16 vjeç:* Vërtetim të gjendjes gjyqësore nga shteti ku jetoni aktualisht; si dhe vërtetim policie nga shtete të tjera ku keni jetuar më parë: në rast se jetoni aktualisht në atë shtet dhe keni më shumë se 6 muaj që po banoni atje, ose në rast se keni jetuar më shumë se një vit në të kaluarën në atë shtet.

Për [Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore](#) nga Shqipëria: aplikoni tek Posta Shqiptare. Tek formulari i aplikimit për vërtetimin e gjendjes gjyqësore që ju jep Posta, **duhet** të shënoni "Ambasada Amerikane". Vërtetimi duhet t'i përfshijë të gjithë emrat dhe/apo mbiemrat e përdorur, përfshirë mbiemrin e vajzërisë (para martese). Vërtetimet e gjendjes gjyqësore të aplikantëve për Vizë Amerikane do të dërgohen direkt në Zyrën Konsullore të Ambasadës Amerikane (gjithmonë nëse ju shënoni “për Ambasadën e SHBA-së” tek aplikimi). Vetëm vërtetimet e marra direkt nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore do të pranohen; aplikanti nuk mund të paraqesë vetë vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Kujdes: Shpesh aplikantët refuzohen vetëm se ata nuk kanë përfshirë **të gjithë emrat/mbiemrat e përdorur** në vërtetim.

Për të dëshmuar që ju keni aplikuar për dëshminë e penalitetit, ju **duhet** t'i dërgoni NVC-së (ose Seksionit Konsullor, në varësi se ku është dosja juaj) një kopje të mandatit të arkëtimit nga Posta Shqiptare me një shënim të shkurtër në Anglisht: “Receipt of Application for the Albanian Police Record”. Të gjitha dokumentet duhet të jenë marrë nga zyrat përkatëse jo



Lista e Dokumentacionit Para Intervistës

më parë se një vit nga data e intervistës. Nëse ka kaluar një vit nga aplikimi juaj i parë, ju duhet të riaplikoni për vizën tuaj të mëtejshme e gjendjes gjyqësore.

↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

Nëse ju keni dorëzuar tek NVC më parë një vërtetim policor nga një shtet tjetër, dhe ai është lëshuar më parë se një (1) vit, dhe ju jetoni akoma në atë shtet, atëherë ju **duhet** të keni me vete në intervistë një vërtetim të marrë kohët e fundit nga ky shtet, pasi vërtetimi i vjetër ka skaduar. Për informacion se si të merrni vërtetime policore nga shtete të tjera lexoni në travel.state.gov.

- Nëse keni qenë ndonjëherë i dënuar me vendim gjyqësor: duhet të sillni **vendimin e plotë nga Gjykata e Rrethit** të përkthyer në Anglisht e të noterizuar, pavarësisht nëse ju është dhënë amnistia, falje, apo nëse dënimi është rehabilituar.
- Nëse keni kryer shërbimin ushtarak: një (1) vërtetim ushtarak për të gjithë aplikantët meshkuj 18 vjeç e lart (përfshihen ata të ditëlindjes pas Shatorit 1990), pavarësisht nëse e keni kryer apo jo shërbimin ushtarak; si dhe për aplikantet femra që kanë kryer shërbim të mëparshëm ushtarak. Ju duhet të aplikoni tek Posta Shqiptare që ta merrni këtë vërtetim.

Kërkesat mbi Dokumentet e Lëshuara nga Autoritetet Greke:

- Certifikatat e Lindjes dhe Vendimet Gjyqësore:** duhet të kenë vulën apostille, si dhe të jenë të përkthyer në Anglisht nga [Zyra e Përkthimeve e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë](#).
- Vërtetimi nga policia greke:**

Aplikantët e moshës 16 vjeç e lart: nëse aplikanti jeton aktualisht në Greqi për më shumë se gjashtë muaj, ose nëse aplikanti ka jetuar më parë në Greqi për më shumë se një vit, atëherë atij ose asaj i kërkohet të aplikojë për vërtetim penal për Përdorim Gjyqësor (Judicial Use penal record -"Antigrafo Pinikou Mitroou Dikastikis Hrisis") nga Ministria Greke e Drejtësisë, Byroja e të Drejtave Penale për të Huajt (Ipiresia Pinikou Mitroou Allodapon), Mesogion 96, 101 79 Athinë, Greqi, tel. 210776-7300, 210776-7185, 210776-7186, dhe 210776-7043.] Ju mund të aplikoni personalisht në zyrën e sipërcituar, ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar duke plotësuar një formular autorizimi ("Exousiodotisi"), të noterizuar nga Ambasada Greke në Tiranë.

Në formularin e aplikimit për vërtetimin penal, sigurohuni që të shënoni me kryq kutinë që kërkon një vërtetim penal për Përdorim Gjyqësor (**Judicial Use** penal record), ndërsa në dy kutitë e fundit, "Arsyeja që Kërkohe" dhe "Përshkrimi", shkruani përkatësisht: **Kërkesë për Vizë dhe Kërkesë për Vizë nga Ambasada Amerikane, Athinë. Ju nuk ktheheni në Byroja e të Drejtave Penale për të Huajt për të marrë vërtetimin tuaj gjyqësor. Byroja e të Drejtave Penale për të Huajt do ta dërgojë vërtetimin tuaj gjyqësor në Konsullatën e SHBA-së në Athinë.**

Udhëzimet e Intervistës



Dërgimi i Dokumenteve në Seksionin Konsullor të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara

Ju duhet t'i dërgoni të gjitha dokumentet origjinale me postë të shpejtë (**jo me DHL**) në Seksionin Konsullor dy (2) javë para datë suaj të intervistës (shikoni [Hapin 3](#)) përveç pasaportës dhe vizitës mjekësore të cilat do t'i sillni në ditën tuaj të intervistës. [Kjo faqe interneti](#) shpjegon se si të dërgoni dokumentacionin në Ambasadë dhe ka një listë të degëve të [postës së shpejtë](#) me të cilat mund të dërgoni dokumentet.

Nëse kanë mbetur më pak se 10 ditë nga data e intervistës, ju mund t'i sillni të gjitha dokumentet në ditën tuaj të intervistës. Kjo mund të kërkojë më tepër kohë derisa të shqyrtohet dokumentacioni në sportel. Nëse Seksioni Konsullor kërkon informacion shtesë apo dokumente shtesë nga ju në ditën tuaj të intervistës, ju duhet t'i dërgoni ato me postën e shpejtë duke hyrë tek [llogaria juaj](#) dhe duke zgjedhur "Seksioni Konsullor më ka kërkuar dokumente shtesë" e duke i bashkëngjitur dokumenteve fletën e autorizimit të korrierit.

Për rastet elektronike, dokumentat e reja është e nevojshme që t'i skanoni dhe t'i ngarkoni elektronikisht në llogarinë tuaj të NVC ne faqen <https://ceac.state.gov/IV/Login.aspx> duke klikuar opsionin "Documents". Origjinalet dërgojini me postë në Seksionin Konsullor..

Ricaktimi apo anulimi i intervistës suaj

Nëse ju nuk keni mundësi reale për t'u paraqitur në datën e caktuar të intervistës, lutemi njoftoni me email tek TiranaUSConsulate@state.gov sa më shpejt. Përfshini emër mbiemër, numrin e çështjes tuaj, datëlindjen, arsyen për vonesën dhe kohën e sugjeruar për takimin e ri. **Mund të ketë një kohë të konsiderueshme pritjeje deri sa t'ju caktohet takimi i ri**, ndaj përpiquni të paraqiteni në datën fillestare të takimit. Për disa kategori vizash me bazë familjare apo bazë punësimi, një vizë bëhet e mundur brenda muajit në të cilin ju caktua takimi për intervistë nga NVC-ja. Aplikantët e lotarisë DV duhet të kenë parasysh që vizat e lotarisë janë numerikisht të limituara dhe duhen lëshuar deri më datë 30 shtator të programit të lotarisë. **Nuk ka asnjë garanci që një vizë lotarie do të jetë në dispozicion në datën e ricaktuar.** Nëse një aplikant Lotarie nuk i është lëshuar një vizë në muajin në të cilin atij i ishte caktuar intervista nga KCC, vizat e vëna në dispozicion të aplikantëve të Lotarisë mund të mos jenë të garantuara për ta. Aplikantët e lotarisë që kërkojnë nga Seksioni Konsullor ricaktim të datës së intervistës së tyre në muaj të mëvonshëm rrezikojnë seriozisht shansin për të marrë vizë. Lutemi konsultoni [Buletinin e Vizave](#) përpara se të kërkonin ricaktim të intervistës.

Lutemi kini parasysh: Ju duhet të regjistroni online takimin tuaj origjinal nga NVC ose KCC (shikoni [Hapin 1](#)) përpara se të mund të ricaktoni takimin. Ricaktimi mundësohet vetëm në një datë pas datës së caktuar të intervistës tuaj.

Procedurat e kontrollit të sigurisë

Të gjithë vizitorët në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara duhet të ndjekin disa procedura sigurie. Ai vizitor që refuzon të kontrollohet nga personeli i sigurisë i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara nuk do të lejohet të hyjë. Për të shmangur vonesat në hyrje për ju dhe për ata pas jush, lutemi sillni vetëm çfarë ju është kërkuar për intervistën tuaj.

Personat shoqërues

Avokatët **nuk** lejohen që të shoqërojnë klientët e tyre në sallën e pritjes apo në intervistë. Vetëm personat e mëposhtëm mund të shoqërojnë një aplikant për vizë në intervistën e tyre:

- Aplikant me aftësi të kufizuara: Aplikantët mund të shoqërohen nga NJË person për ta ndihmuar nëse ata janë të moshuar, të pamundur, apo minorenë. Lutemi njoftoni paraprakisht me email tek TiranaUSConsulate@state.gov që të mos hasni vonesa.



↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

Tarifat e vizave imigruese

Nëse ju nuk i keni paguar të gjitha tarifat e aplikimit për vizë nëpërmjet NVC-së, apo qendrës së caktimit të takimeve për vizat K të fejesës, lutemi përgatituni që ta paguani këto tarifa në ditën tuaj të intervistës. Të gjitha tarifat duhen paguar ose në Dollarë Amerikanë, ose në Lekë. Seksioni Konsullor pranon vetëm para në dorë (kesh). *Kini parasysh që nëse gjendeni i pakualifikuar për të marrë një vizë, tarifa e aplikimit për vizë nuk rimbursohet.* Një listë e plotë e tarifave gjendet në travel.state.gov

Mos bëni plane udhëtimi jashtë Shqipërisë

Nëse viza juaj u miratua, ne do ta mbajmë pasaportën tuaj në Ambasadë për përgatitjen e paketës suaj imigruese dhe për printimin e vizës në pasaportën tuaj. Ne do t'ju kthejmë pasaportën tuaj vetëm me anë të shërbimit postar (shikoni [Hapin 1](#)). Mos bëni plane udhëtimi për në Shtetet e Bashkuara derisa të keni marrë pasaportën tuaj me vizë në dorëzim.

Pas Intervistës Tuaj



Vetëm një oficer konsullor mund të marrë një vendim mbi një vizë pasi të ketë shqyrtuar aplikimin tuaj zyrtar dhe t'ju ketë intervistuar. Nuk ka garanci që juve do t'ju lëshohet viza. Mos shisni shtëpinë, makinën apo pronën, mos jepni dorëheqjen nga puna dhe mos blini një biletë të parimbursueshme derisa të keni marrë vizën tuaj imigruese në dorëzim.

Në rast se nevojitet informacion shtesë

Në disa raste, oficeri konsullor nuk mund të marrë një vendim mbi një aplikim për vizë pasi ai ose ajo ka nevojë të shqyrtojë dokumente shtesë ose çështja mund të kërkojë proces të mëtejshëm administrativ. *Kur ju kërkohen dokumente shtesë*, oficeri konsullor do t'ju japë një fletë refuzimi ku renditen dokumentet shtesë. Kjo letër përmban informacion se si t'i dërgoni këto dokumente në Seksionin Konsullor.

Procesi administrativ kërkon kohë shtesë pas intervistës. Shumica e proceseve administrative zgjidhet brenda 60 ditëve nga dita e intervistës. Gjithsesi, kohëzgjatja varet nga rrethanat individuale të çdo rasti. Përpara se të kontaktoni Zyrën Konsullore rreth statusit të procesit administrativ, lutemi prisni të paktën 60 ditë nga data e intervistës.

Çfarë ndodh pas miratimit të vizës suaj

Pasaporta, Viza, and Paketa Imigruese e Vulosur (per rastet jo elektronike) – Ne do ta ngjism vizën tuaj në një fletë të pasaportës tuaj. Lutemi kontrolloni vizën tuaj për t'u siguruar që nuk ka gabime të të dhënave biografike. Ne do t'ju japim gjithashtu një zarf të vulosur që mban dokumentacion që ju duhet t'ia dorëzoni autoriteteve të imigracionit të Shteteve të Bashkuara kur të hyni për herë të parë në SHBA. ***Mos e hapni këtë zarf. Ju duhet ta mbani atë në një bagazh dore së bashku me diskut e rrezeve X dhe t'ia dorëzoni autoriteteve të Imigracionit të Shteteve të Bashkuara.***

Traifa e USCIS për Imigrantët – Të gjithë individët, të cilëve u është lëshuar një vizë imigruese, **duhet të paguajnë [Tarifën e Imigrantit](#)** për Shërbimet e Shteteve të Bashkuara për Nënshitetësinë dhe Imigracionin **përpara se të udhëtojnë** në Shtetet e Bashkuara. Kjo tarifë shërben për shqyrtimin e statusit tuaj të rezidentit dhe për të printuar Kartën tuaj të Banorit të Përhershëm të Ligjshëm (karta e gjelbër). Vetëm këto kategori vizash janë të përjashtuar nga kjo tarifë: birësimet, rezidentët në kthim (SB1) dhe vizat e fejesës K.

Kur Duhet të Udhëtoni Ju – Ju duhet të hyni në Shtetet e Bashkuara përpara datës së skadimit të vizës tuaj, e cila është e limituar, zakonisht 6 muaj, sipas skadimit të vizës tuaj mjekësore. Vizës suaj nuk mund t'i zgjatet afati dhe të gjitha tarifatat janë të pakthyeshme. Aplikanti kryesor duhet të hyjë **përpara ose në të njëjtën kohë** me pjesëtarët e familjes që janë 25erivateve në rastin e tij ose të saj. Në rast se pjesëtarët e familjes që janë 25erivateve po udhëtojnë më vonë nga aplikanti kryesor, ata duhet të kenë me vete kopje të dy faqeve të pasaportës së aplikantit kryesor ku tregohet viza dhe **[vula e pranimit nga USCIS](#)**. Pa këtë dokument ju do të hasni vështirësi në nisje. Fëmijët, të cilëve u është lëshuar një vizë përpara se të mbushin 21 vjeç duhet të hyjnë në SHBA **përpara se të mbushin 21 vjeç**, pasi humbin të drejtën e statusit të imigrantit (përveç rasteve kur fëmija ka përfituar nga Akti i Mbrojtjes së Statusit të Fëmijës (CSPA)).

↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

Pas Intervistës Tuaj



e Kartës së Gjelbër – Formulari juaj I-551, Karta e Banorit të Përhershëm të Ligjshëm, njohur edhe si karta e gjelbër, do ju dërgohet me postë në adresën në SHBA që ju keni deklaruar në formularin e aplikimit për vizë (apo në adresën që i deklaruat oficerit të imigracionit në pikën e hyrjes në SHBA). Ky është dokument shumë i rëndësishëm që dëshmon se ju keni leje për të banuar në Shtetet e Bashkuara. *Nëse juve ju duhet të udhëtoni jashtë SHBA-së përpara se të merrni kartën e gjelbër, lutemi konsultohuni me faqet e internetit të [USCIS](#) dhe të [Mbrojtjes së Kufijve dhe Doganave \(CBP\)](#) mbi rregullat dhe se çfarë dokumentesh ju duhen për të rihyrë në SHBA. Ne gjithashtu rekomandojmë që ju të flisni edhe me kompaninë ajrore për t’u siguruar që jeni në përputhje me rregullat e tyre. Pasi t’ju jetë lëshuar karta e gjelbër, ju nuk duhet të qëndroni jashtë Shteteve të Bashkuara më shumë se një vit, përndryshe ju do të humbisni statusin tuaj të Banorit të Përhershëm të Ligjshëm.*

Mbi Fëmijët – Në Shtetet e Bashkuara fëmijëve u kërkohet të kenë kryer disa vaksina përpara se ata të mund të regjistrohen në shkollë. Ne rekomandojmë që ju të sillni kopjen e vaksinave që ju dha mjeku i autorizuar me ju në Shtetet e Bashkuara. Nëse fëmija është i birësuar, apo nëse keni kujdestari të plotë nga vendimi gjyqësor mbi divorcin, ju duhet të merrni me vete në SHBA një kopje të këtij vendimi. Juve mund t’ju kërkohen këto dokumente (të përkthyer në Anglisht, e të noterizuara) për të regjistruar fëmijën në shkollë, për të marrë shërbim mjekësor, dhe për nënshtetësinë e fëmijës.

Informacion për Imigrantët e Rinj – Lutemi vizitoni faqen e internetit të USCIS për informacion të volitshëm për imigrantët e rinj në SHBA. Ju mund ta lexoni publikimin e tyre në [uscis.gov](#).

Aplikantët e Vizave të Lotarisë DV – Informacion Shtesë



Nëse ju jeni aplikant i vizës së Lotarisë, **të gjitha udhëzimet e mësipërme aplikohen për ju**, përveç formularit të garancisë së mbështetjes, i cili është i ndryshëm për ju. Lutemi caktoni takimin mjekësor **fiks tre javë** para intervistës tuaj; regjistroni [datën e takimit për intervistë](#); dhe përgatitni dokumentacionin e kërkuar.

*Më poshtë janë udhëzimet **vetëm** për aplikantët e vizave të Lotarisë.*

Çfarë duhet të sillni

Përveç dokumenteve të renditura tek [Lista e Dokumentacionit Para Intervistës](#) në këtë udhëzues, aplikantët e lotarisë DV duhet të dërgojnë dokumentacionin e mëposhtëm me postë të shpejtë (**jo me DHL**) dy (2) javë përpara datës së tyre të intervistës për vizë:

- Letrën e takimit që printuat nga “Statusi i Kontrollit të të Regjistruarve - Entrant Status Check” tek [Faqja e internetit të Lotarisë](#).
- Tarifa e Aplikimit për Vizën e Lotarisë DV prej \$330 ose ekuivalenti në Lekë për secilin aplikant. (**E RËNDËSISHME: Mos kryeni ndonjë pagesë paraprake. Ajo do të kryhet në ditën tuaj të intervistës në Seksionin Konsullor.**)
- Dokumente që tregojnë që ju kualifikoheni ose me arsimin e mesëm OSE keni dy (2) vite përvojë pune brenda pesë viteve të fundit, e cila të plotësojë kriteret e punëve të kualifikueshme për lotarinë (vetëm për aplikantin kryesor; për më tepër informacion, lexoni në [travel.state.gov](#)).

Nëse ju keni një dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kjo aplikohet vetëm për aplikantin/aplikanten kryesor/e), atëherë ju duhet të dërgoni me postë të shpejtë mbi 2 javë para intervistës tuaj:

- Dëftesa juaj **origjinale** e pjekurisë e shkollës së mesme, e përkthyer në Anglisht, plus një (1) fotokopje të këtij dokumenti; ose në mungesë të dëftesës origjinale një vërtetim notash të lëshuar kohët e fundit nga shkolla e mesme, të përkthyer në Anglisht, plus një (1) fotokopje të këtij dokumenti; ose nëse shkolla juaj është mbyllur, një vërtetim nga Arkivi i Shtetit, i cili të përmbajë edhe faqen e regjistrit të Amzës tuaj me lëndët e studiuara, të përkthyer në Anglisht, plus një (1) fotokopje të këtij dokumenti.
- Për dëftesat e pjekurisë të shkollës së mesme të lëshuara përpara vitit 1990: sillni dëftesën origjinale dhe vërtetim notash të lëshuar kohët e fundit të përkthyer në anglisht dhe një (1) fotokopje të tij;
- Nëse keni kryer arsimin e lartë, përveç dëftesës së shkollës së mesme do të sillni edhe Diplomën **origjinale** të Shkollës së Lartë dhe një (1) fotokopje e saj. Përkthimi dhe noterizimi i diplomës së shkollës së lartë kërkohet vetëm nëse keni kryer studimet jashtë Shqipërisë.
- Dëftesa e Pjekurisë (ose Vërtetimi i Notave në mungesë të dëftesës së pjekurisë) për aplikantët që e kanë kryer shkollën e mesme në Shqipëri duhet të vuloset nga: 1) Drejtoria Rajonale Arsimore e Rrethit, 2) nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe 3) të legalizohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë. Dëftesa e pjekurisë dhe Vërtetimi i Notave DUHEN përkthyer në anglisht. Sigurohuni që sekretarja e shkollës të përfshijë në mënyrë korrekte të gjitha lëndët që keni studiuar tek vërtetimi i notave.
- Aplikantët që e kanë kryer shkollën jashtë Shqipërisë duhet ta legalizojnë dëftesën e pjekurisë (ose vërtetimin e notave në mungesë të saj) sipas procedurave të shtetit përkatës dhe ta përkthejnë në anglisht dhe noterizojnë nga një noter publik i licensuar.

↓ Vazhdon në faqen tjetër ↓

Aplikantët e Vizave të Lotarisë DV – Informacion Shtesë



- Një garanci mbështetjeje nga një sponsor në Shtetet e Bashkuara (ky mund të jetë një i afërm, ose një mik, i cili duhet të jetë ose Nënshtetas Amerikan, ose Banor i Përhershëm i Ligjshëm (me green card)):
 - [Formulari I-134](#) (Affidavit of Support) - Një garanci financiare nga një nënshtetas amerikan apo me green card. **Vini re:** pika 21 e formularit duhet plotësuar: *“I intend to make specific contributions...”* Ky dokument nuk duhet të jetë më i vjetër se 12 muaj kur të paraqitet në ditën e intervistës,
 - Fotokopje të pasaportës amerikane të sponsorit, të certifikatës së natyralizimit, ose fotokopje të kartës së banorit të përhershëm të ligjshëm,
 - Taksat e vitit të fundit (Formulari 1040), ose [një transkript apo kopje të taksave](#) të marrë direkt nga [Shërbimi i Brendshëm i të Ardhurave](#).
 - Formularët W-2 të vitit të fundit për të gjitha punët,
 - Nëse sponsori është i martuar, edhe bashkëshortja e tij duhet të dorëzojë Formularin e saj I-134 të firmosur shoqëruar me fotokopje të pasaportës amerikane të sponsorit, të certifikatës së natyralizimit, ose fotokopje të kartës së rezidentit të përhershëm të ligjshëm.
 - Sigurohuni që të ardhurat e sponsorit të jenë [mbi 100 përqind të nivelit të varfërisë \(poverty guideline\)](#), që vendoset çdo vit nga Departamenti Amerikan i Shërbimeve të Shëndetit dhe Njeriut, përndryshe ju duhet të gjeni një sponsor tjetër.

Rishikim i aplikimit tuaj fillestar për Lotarinë DV

Përpara intervistës tuaj për vizë, ne ju rekomandojmë të rishikoni të dhënat që keni dhënë në aplikimin tuaj fillestar për lotarinë. Sigurohuni që të keni dhënë informacionin e saktë mbi statusin tuaj civil në momentin e aplikimit fillestar. Nëse ju ishit i/e martuar në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë, ju duhet të kishit përfshirë bashkëshortin/en tuaj në atë aplikim fillestar (edhe nëse keni qenë në proces divorci). Përbashkëshorti është Nënshtetas Amerikan, ose Banor i Përhershëm i Ligjshëm.

Gjithashtu, ju duhet të kishit përfshirë të gjithë fëmijët tuaj të pamartuar dhe nën 21 vjeç në momentin e aplikimit fillestar. Me fëmijë nënkuptohen fëmijët tuaj biologjikë, dhe thjeshtërit- fëmijët e bashkëshortit/es tuaj, apo fëmijë që i keni birësuar ligjërisht, pavarësisht nëse jetojnë me ju ose jo.

Sigurohuni që ju keni ngarkuar fotografinë e saktë për çdo pjesëtar të familjes në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë. Ngatërrimi i fotografive në aplikimin fillestar do të rezultojnë në refuzimin e vizës për ju dhe familjen tuaj.

Mosdeklarimi i bashkëshortit/es ekzistues, apo i fëmijës ekzistues në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë do të rezultojnë në refuzimin e vizës për ju dhe familjen tuaj. Çdo tarifë e paguar ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara për aplikimin tuaj për vizë nuk rimbursohet. Nëse në momentin e aplikimit fillestar, ju nuk keni përfshirë në një fëmijë ekzistues, apo një bashkëshort/e me të cilën ishit i martuar (pra, statusi juaj civil ishte “i martuar” në momentin e aplikimit fillestar), atëherë mos vazhdoni me procedurën e aplikimit për vizë. Ju mund të rishikoni të kriteret e pranueshmërisë në travel.state.gov.